



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:089173

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05625071

P.nr.114/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe bashkëpunëtorin profesional Izet Hyseni, në çështjen penale kundër të akuzuarit: L. U. i akuzuar për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1212/2024 të dt.31.03.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më datë 25.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Menduhi Kastrati, të akuzuarit, si dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare avokati F. B., në të njëjtën ditë mori publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

L. U., nga i ati Xh. dhe e ëma N. e vajzërisë Sh., i lindur më dt....., në Prishtinë, me vendbanim në fshatin L., rruga “D.”, Komuna e Podujevës, me numër personal të identifikimit:....., ka të kryer shkollën fillore, profesioni i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike-financiare, i pa martuar, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Më datë 06.02.2024, rreth orës 16:30 në fshatin L., Komuna e Podujevës, i pandehuri L. U. në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët ka mbajtur në pronësi armë të ftohtë-thikë Boker, të cilën ka dorëzuar në polici me rastin e paraqitjes së një rasti sulm nga persona të paidentifikuar.

- Me këtë e ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 366 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 242, 364, 365, 368, 369, 449 të KPPRK-së, i:

## G J Y K O N

- I. Të pandehurin dënim me gjobë në shumë prej 250.00 € (dyqind e pesëdhjetë/euro), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.
- II. Nëse i akuzuari nuk e paguajnë dënimin me gjobë pas afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20€ (njëzet euro), të papaguara do t'i llogaritet 1(një) ditë burg.
- III. Konform nenit 366 të KPRK-së, të akuzuarit, i konfiskohet një (1) thikë, si mjet i kryerjes së veprës penale.
- IV. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20.00€ (njëzet/euro), gjithashtu në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20.00€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1212/2024 të dt.31.03.2024, kundër të akuzuarit: L. U. i akuzuar për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka treguar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më dt.25.04.2024, në të cilën prezantuan Prokurori e Shtetit Menduhi Kastrati nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, si dhe i akuzuari me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare avokatin F. B..

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar i akuzuari lidhur me veprën penale që i vihet në barrë ka deklaruar: E pranojë fajësinë, është hera e parë që jam në gjykatë, ky rast nuk do të përsëritet më asnjëherë, lus gjykatën që të më shqiptoi një dënim sa më të lehtë, jam i pa punë.

Mbrojtësi i të pandehurit, Av. F. B. lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij deklaroi: Kërkojmë nga gjykata që me rastin e marrjes së dënimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, të ketë parasysh pranimin e fajësisë, armën - thikën i pandehuri e ka vet dorëzuar në polici i njëjti është i pa hetuar apo i pa dënuar me parë, andaj ti shqiptohet një dënim sa më i butë, duke marr parasysh edhe gjendjen e tij ekonomike dhe rrethanat tjera lehtësuese të parapara në dispozitat ligjorë.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se e mbështet pranimin e fajësisë nga i pandehuri sepse i njëjti është bërë me vullnetin e tyre të plotë dhe bazuar në shkresat e lëndës.

Gjykata pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtësit të akuzuarit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet të akuzuarit, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpall fajtor dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila e vihet në barrë, pendimin dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëritet, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti, andaj gjykata duke i vlerësuar këto rrethana ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësin e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burg për të akuzuarit është marrë në kuptim të nenit 43 të KPRK-së.

Vendimi konfiskimin e thikës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 366 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal  
P.nr.114/2024, me dt.26.04.2024

G j y q t a r i

---

Minir Hoti

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.